

VENDIM
Nr. 275, datë 7.5.2014

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 513, DATË 13.6.2013, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE E TË
DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË
HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 30, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme dhe të ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në aneksin 3, “Lista e shteteve, shtetasit e të cilave hyjnë pa viza në Republikën e Shqipërisë, dhe dokumenti që duhet të paraqesin”, të përmendur në pikën 2, shkronja “A”, të kreut II, “Kriteret dhe dokumentacioni për pajisjen me vizë”, të vendimit nr. 513, datë 13.6.2013, të Këshillit të Ministrave, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Rusia, Moldavia, Arabia Saudite, Emiratet e Bashkuara Arabe, Katar, Oman, Kuvajt, me dokumentin pasaportë, për periudhën 25 maj deri më 30 shtator 2014.”.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

